



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 1051/10 Prot.

Tiranë, më 23.05.2020

V E N D I M

Nr. 50, Datë 23.05.2020

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË DIVJAKË “MBI AUDITIMIN FINANCIAR
DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”**

(Për periudhën nga data 01.07.2017 deri më datën 31.12.2019)

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Divjakë me objekt “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë”, për periudhën 01.07.2017 deri më 31.12.2019, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

VENDOSA:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Divjakë sipas programit të auditimit nr. 1051/1 prot, datë 26.12.2019, për periudhën 01.07.2017 – 31.12.2019.
- II.** Të miratoj Opinionin e Auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Për drejtimin e Bashkisë Divjakë:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Divjakë, për vitet ushtrimore 2017 dhe 2018, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, Fondet neto, Investimet e Aktivet Afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i kualifikuar¹

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2018, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit, që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 1700) Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas mendimit tonë kanë efekt në pozicionin financiar të llogarive të Bashkisë Divjakë. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në gjetjet e raportit Përfundimtar të Auditimit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Divjakë²

Ne kemi audituar përputhshmërinë³ e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërinë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Divjakë, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2017, 2018 dhe 2019.

Opinion i kualifikuar.

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Divjakë, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

Baza për opinion e kualifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përse i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve të cilat nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi.

¹ Një **opinion i kualifikuar** jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

² **ISSAI 4100** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

³ Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se:

-Në Bashkinë Divjakë, sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

- Nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Divjakë dhe 4 Njësitë Administrative, për mos pagimin në afat të detyrimit tatimore nga subjektet më datën 31.12.2019 vlera e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore në shkallë bashkie është në shumën prej 307,653,839 lekë, e cila përfaqëson:

-284 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh, në vlerën 27,637,626 lekë

-9,146 familjarë janë debitorë për taksat e tokës në vlerën 264,844,245 lekë

-Për debitorë familjarë të tarifave vendore në vlerën 15,171,968 lekë, nga të cilat:

-rreth 2911 familjarë në vlerën 9,213,500 lekë, nuk kanë paguar taksat në Ujësjellës sha Divjakë.

- 5,958,468 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Stoku i faturave të palikuiduara paraqitet në shumën 62,125,285 lekë dhe detyrime për 5 vendime gjyqësore në shumën 3,234,310 lekë.

-Në zbatimin e punimeve të 8 kontratave u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **2,511 mijë lekë**.

-Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar veprime jo në përputhje me kërkesat ligjore në 11 procedura ku është evidentuar përdorim jo sipas 3-E të shumës prej 16,127 mijë lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Divjakë.

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë për publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e autorizimeve/licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në zbatim të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 të Bashkisë Divjakë, për periudhën gjashtë mujori i dytë 2017, dhe viteve 2018 e 2019, konstatohet se në bashkinë Divjakë ushtrojnë aktivitet 4 subjekte të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët në vlerën 2,900,000 lekë sipas aneksit B3/1 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 66-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandim: Bashkia Divjakë të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e shumës 2,900,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9, nga subjektet sipas pasqyrës së mëposhtme:

Aneksi nr.B3/1 Pasqyra përmbledhëse e subjekteve që nuk ka likuiduar tarifën e licencimit/autorizimit

Nr	Emri Shoqërisë	NIPTI	Vendndodhja	Detyrimi	Arsyeja	Diferenca lekë
1	E...S Shpk	K...T	Çermë	1.000.000	mungon autorizim 14.7.17-14.7.19	400.000
2	K...I shpk	L...M	Çerëm	1.000.000	mungon autorizimi 26.5.17-5.12.2019	500.000
3	T...i&F...	K...A	Këmishtaj	1.000.000	punon pa autorizim 4.10..2019	1.000.000
4	Vëllezërit M...i	K...I	Tërbuf	1.000.000	punon pa autorizim 20.12.2018	1.000.000
Totali						2.900.000

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Divjakë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk është hartuar strategjia e riskut, gjurma e auditimit. Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se 5 vjet. Njësia ka në strukturë specialist të IT-së, por nuk ka programe të licencuara dhe për rrjedhojë nuk ka as programe për mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik. Stafit drejtues dhe ai zbatues me gjithë punën e mirë ka ende mangësi në njohjen e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe manualin përkatës në zbatim të këtij ligji. Veprimet e mësipërme nuk përputhen me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe nenin 32, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 42-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Titullari i njësisë vendore dhe menaxherët kryesor të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë publike. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë sigurimin e programeve kompjuterike të licencuara si dhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik. Të hartohet strategjia e riskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës për secilin sektor dhe në nivel institucioni.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga vlerësimi i pyetësorit me drejtues dhe nëpunës të Bashkisë Divjakë rezultoi se 52% e kësaj strukture nuk kanë marrë pjesë fare në trajnime ose janë trajnuar jashtë programit të njësisë vendore, duke nxjerrë si shkak kryesorë mungesën e sigurimit të transportit nga bashkia për në Shkollën Shqiptare të Administratës (ASPА) në Tiranë ku kryhen trajnimet e administratës. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 42-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Divjakë të marrë masa për sigurimin e pjesëmarrjes së nëpunësve të administratës në trajnimet që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës (ASPА) duke marrë përsipër transportin dhe detyrimet e tjera në përputhje me kudrin ligjor në fuqi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka arsyetuar ndryshimet e planifikimit vjetor të auditimit. Nuk ka çelur në përputhje me standardet e pranuar dosjet e përhershme të auditimit, veprim që nuk përputhet me kërkesat e manualit të auditit të brendshëm, Kapitulli VI, pika 6. Subjektet ndaj të cilëve është ushtruar auditimi i brendshëm nuk kanë hartuar e dërguar pranë Njesisë së Auditit të Brendshëm planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, veprim që bie në kundërshtim me standardet e Kapitullit VI të MAB. Dokumentacioni i përfshirë në dosjet koherente nuk përputhet me inventarin e dosjes (*Trajtuar më hollësisht në faqet 44-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa për celjen dhe administrimin e dosjeve të përhershme të subjekteve të audituar, të kërkoj nga subjektet objekt auditimi të paraqesin në kohë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, gjithashtu të përgatisë dhe administrojë inventarin e dosjeve koherente në përputhje me manualin e AB.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Divjakë nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH për masat shpërblim dëmi me vlerë 13,598,396 lekë, veprim në kundërshtim me nenet 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2015, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, të marrë në analizë situatën e zbatimit të kërkesave sipas shkresës nr. 1005/70, datë 20.12.2018 për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm, të dalin përgjegjësitë individuale dhe institucionale për mos vlerësim dhe zbatim të masave të rekomanduara nga KLSH, si dhe të hartohet plan-veprimi specifik për vlerësimin sipas afateve administrative për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se për 6 rekomandime për shpërblim dëmi, të dërguara nga KLSH me shkresën e saj nr.1005/70, datë 20.12.2018, protokolluar në Bashkinë Divjakë me shkresën nr.4311, datë 24.12.2018, me vlerë **7,361,198** lekë, nuk janë ezauruar të gjitha rrugët ligjore për kërkimin e dëmit, duke bërë që të kalojnë afatet ligjore të parashikuar nga neni 112, 115, dhe 120 të Kodit Civil të RSH, dhe konkretisht rekomandimi nr.1.1, 5.6, 8.9, 9.10, 10.11, dhe 11.13 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën e saj nr.1005/70, datë 20.12.2018, protokolluar në Bashkinë Divjakë me shkresën nr.4311, datë 24.12.2018 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Divjakë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të bëjë kontabilizimin dhe të nxjerrë urdhër-zhdëmtimeve për shumët e pakontabilizuar, me vlerë **7,361,198** lekë

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Divjakë, ka trashëguar një kontratë qiraje e cila është vlerësuar nga KLSH e lidhur në kundërshtim me ligjin dhe në dëm të qeradhënësit dhe i ka rekomanduar Bashkisë Divjakë që të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 1,460,184 lekë, nga subjekti J.R. si dhe të bëj përditësimin e kontratës me subjektin, sipas referencës ligjore aktuale. Nga ana e Zyrës Juridike të kësaj bashkie nuk është kryer asnjë procedurë për korigjimin e kontratës, dhe nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është kryer asnjë veprim për arkëtimin e shumës së rekomanduar. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandim: Zyra Juridike në Bashkinë Divjakë, të marrë masa për verifikimin e kontratës së mëparshme, kushtet ligjore në kohën e lidhjes së saj dhe të veprojë në përputhje me kuadrin ligjor për korrjizimin ose lënien në fuqi nëse vlerësohet e ligjshme, duke bërë argumentimin ligjor për cdo rast.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Divjakë, për periudhën objekt auditimi ka trashëguar detyrime të prapambetura nga vitet 2012 e në vijim, ku për 14 vendime gjyqësore në fund të vitit 2017, gjendja paraqitet në vlerën 5,987,978 lekë, në fund të vitit 2018 për 12 vendime gjyqësore gjendja paraqitet në vlerën 7,887,700 lekë dhe, në fund të vitit 2019, për 5 vendime gjyqësore gjendja paraqitet në vlerën 3,234,310 lekë, me objekt padie në 2 raste për shpërblim anëtar qarku, në 4 raste për zbatim kontrate dhe në 8 raste largim nga puna. Për këto procese gjyqësore të humbura Bashkia Divjakë nuk ka analizuar shkaqet dhe nuk ka marrë masat ndaj personave përgjegjës. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 62 dhe 102; me Udhëzimin nr. 2, datë 09.01.2015 “Vendimet gjyqësore”, pika 6.1; me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, neni 12, pika 3 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandim: Bashkia Divjakë të marrë masa për të likuiduar detyrimet për 5 vendimet gjyqësore në vlerën 3,234,310 lekë të mbetura në fund të vitit 2019 si dhe të eliminojë sa të jetë e mundur krijimin e këtyre lloj detyrimeve dhe, në rastet e krijimit të detyrimeve të reja për vendime gjyqësore, të analizojë shkaqet dhe të marrë masa ndaj personave përgjegjës.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga testimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës për periudhën 6-mujori i dytë viti 2017, viti 2018 dhe viti 2019 rezultoi se janë kryer pagesa me urdhërshpenzime në 267 raste në vlerën 211,642,127 lekë mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion ku, në pjesën më të madhe të rasteve, janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, ndërsa një pjesë e rasteve ka ardhur edhe si rezultat i vendosjes së limit të kufizuar të arkës për likuidim nga MFE në fund të viteve ushtrimore 2017-2018, duke shtyrë radhën e likuidimeve. Këto veprime janë në mosrespektim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 57-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: Bashkia Divjakë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshirë kufizimet e MFE) për likuidimin e faturave në kohë me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Buxheti për vitin 2017, 2018 dhe 2019 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme realizimi ku, për vitin 2017 paraqitet në masën 87 %, për vitin 2018 në masën 83% dhe për vitin 2019 në masën 79%. Në këtë nivel realizimi ka ndikuar niveli i ulët i fondeve për shpenzime operative për vitin 2017 në masën 60%, për vitin 2018 në masën 68% dhe për vitin 2019 në masën 79%, pra kemi planifikim me rezervë të këtij zëri buxhetor. Po kështu edhe fondet për investime të financuara nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar janë realizuar për vitin 2017 në masën 75%, për vitin 2018 në masën 48% dhe për vitin 2019 në masën 50%.

Kanë ndodhur ndryshime të vazhdueshme, konkretisht për vitin 2017 janë kryer 8 shtesa në vlerën 384,696 mijë leke, për vitin 2018 janë kryer 10 shtesa dhe 1 pakësim në vlerën 354,704 mijë lekë dhe për vitin 2019 janë kryer 10 shtesa dhe 2 pakësime në vlerën 354,704 mijë lekë të cilat tregojnë qartë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Duke u nisur nga burimi i financimit shpenzimet buxhetore janë përballuar: Për vitin 2017, nga të ardhurat e veta në shumën 64,815 mijë lekë ose në masën 7%, nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike në shumën 340,434 mijë lekë ose në masën 36 %, nga transfertat e

kushtëzuar në shumën 187,420 mijë lekë ose në masën 20% dhe, nga FZHR dhe Ministritë e Linjës, në shumën 352,196 mijë lekë ose në masën 37%.

Për vitin 2018, nga të ardhurat e veta në shumën 79,157 mijë lekë ose në masën 12%, nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike në shumën 265,332 mijë lekë ose në masën 39%, nga transfertat e kushtëzuar në shumën 194,614 mijë lekë ose në masën 28% dhe, nga FZHR dhe Ministritë e Linjës, në shumën 140,101 mijë lekë ose në masën 21%.

Për vitin 2019, nga të ardhurat e veta në shumën 80,000 mijë lekë ose në masën 12%, nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike në shumën 302,226 mijë lekë ose në masën 44 %, nga transfertat e kushtëzuar në shumën 188,117 mijë lekë ose në masën 27% dhe, nga FZHR dhe Ministritë e Linjës, në shumën 118,703 mijë lekë ose në masën 17%.

Detyrimet e papaguara paraqiten për vitin 2017 në shumën 67,902,316 lekë ose në masën 6% të shpenzimeve totale të planifikuara, për vitin 2018 në shumën 29,065,304 lekë ose 3% të shpenzimeve totale të planifikuara dhe për vitin 2019 në shumën 62,125,285 lekë ose në masën 7% kurse të ardhurat për vitin 2017 janë realizuar në masën 42%, për vitin 2018 në masën 51% dhe për vitin 2019 në masën 47%, tregues këta që tregojnë për një planifikim të të ardhurave mbi një bazë jo reale, duke i fryrë ato për efekt të rritjes së fondeve të planifikuara për shpenzime. Këtë fakt e tregon dhe vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore, e cila paraqitet në nivele të larta, përkatësisht në shumën 300,776,075 lekë në vitin 2017, në shumën 278,715,743 lekë në vitin 2018 dhe në shumën 327,955,759 lekë në vitin 2019, pa llogaritur debitorët familjarë.

Për vitet 2017, 2018 dhe vitin 2019 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetimit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat. Nuk janë formuluar produktet dhe kostot e tyre si dhe realizimi i tyre, por janë evidentuar aktivitetet e synuara dhe ato të realizuara dhe shpenzimet e kryera për to, duke evidentuar fondet e planifikuara dhe realizimi i tyre si dhe burimet e financimit. Nuk janë evidentuar në ç'masë janë arritur objektivat. Nuk janë analizuar shkaqet e morealizimeve dhe përcaktuar masat korrigjuese për përmirësimin e situatës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" nenet 42, 43, 47, 50, 52 dhe 65, me UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" i ndryshuar, pikat 253, 354, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", "Detyrimet e prapambetura të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore" pikat 82-91 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandim: Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria Financës dhe Buxhetit të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen në fund të vitit 2019 të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale 62,125,285 lekë, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Divjake për dy vitet 2017 dhe 2018 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, kërkesë e parimeve të kontabilitetit të pranuar, pasi përveç Aparatit, Bashkia Divjake ka në varësi njësinë shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Komunale e cila është me bilanc më vete dhe fondet i akordohen nga Bashkia. Për këtë arsye në mbyllje të vitit ushtrimor bashkia krahas pasqyrave financiare të veta duhet të evidentonte informacionin kontabël të PF të Agjencisë së Shërbimeve Komunale dhe të pasqyronte të përmbledhur në formatin 9 të PF të Bashkisë Divjake. Këto veprime janë në kundërshtim me me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 62 "Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit", me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor

dhe njësisve që varen prej tyre si dhe të njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, pika 5 “Për Konsolidimin e Pasqyrave Financiare”, me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu IV, pika 103 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 79-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandim: Bashkia Divjakë të marrë masa për hartimin e Pasqyrave Financiare të konsoliduara në nivel bashkie, duke përfshirë në pasqyrat financiare të njësisë shpenzuese “Aparati i Bashkisë” edhe të njësisë shpenzuese të vartësisë me llogari më vete “Agjencisë së Shërbimeve Komunale.”, me qëllim sigurimin e informacionit kontabël të konsoliduar për të ardhurat dhe shpenzimet të realizuara nga veprimtaria e tyre ekonomiko-financiare.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 18,960,784 lekë dhe në mbyllje të vitit 2017 në vlerën 3,399,254 lekë, llogari e cila debitohet për të drejtat, pra të ardhurat e konstatuara (për çmimet e shitjeve) dhe kreditohet për arkëtimet për të ardhurat nga shitja, ndërkohë që Bashkia Divjakë nuk ka veprime ekonomike apo transaksione financiare lidhur me shitjen. Kjo vlerë prej 18,960,784 lekë në fakt i përket gjendjes së llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari lidhur me to” të paraqitur në pasiv të bilancit, që përfaqësojnë detyrime të konstatuara të institucionit ndaj të tretëve për blerje aktivesh. Nisur nga këto arsytetime theksojmë se ky kontabilizim në llog.411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” është i gabuar dhe vlera prej 18,960,784 lekë në mbyllje të vitit 2018 dhe vlera prej 3,399,254 lekë në mbyllje të vitit 2017 duhej të përfshihej në gjendjen e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, llogari e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale që merren nga buxheti i shtetit). Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 86-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Divjakë në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 të kryejë veprimet kontabël sistemuese në aktiv të bilancit për gjendjen në vlerën 18,960,784 lekë duke debituar llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në kredi të llogarisë 411 “Klientë dhe llogari të ngjashme” për efekte të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2018 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2019 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlera e mbetur në fund të vitit 2018 prej 12,658,902 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, i përket 38 projekt-studime për investime të kryera që nga viti 2017, e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 pika 2. klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), Kreu II. pika 16/b.d, me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qendrueshme të Patrupëzuar”, Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 90-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit në Bashkinë Divjakë të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për cdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 2 artikuj aktive materiale në vlerën 340,464 lekë si: a. Shpronësim për varreza fshati Shënepremte në vlerën 109,200 lekë dhe b. Rivitalizimi i sheshit qendror Bashkia Divjake në vlerën 231,264 lekë të cilat nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 210 "Toka Troje Terrene". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 pika 2. klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), Kreu II. pika 16/b.d, me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qendrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” (Trajtuar më hollësisht në faqet 92-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Divjakë të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas klasifikimit që i përket këtij posti, duke debituar llog 210 "Toka Troje Terrene" në kredi të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për vlerën 340,464 lekë.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” konstatohet se janë kontabilizuar gabim 6 artikuj aktive materiale aftagjata në vlerën 41,024,233 lekë si: rikonstruksion lulishte, pemë dekorative, materiale elektrike e ndërtim palestere e terrene sportive, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarije kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" dhe llogarisë 212 “Ndërtesa” e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 pika 2. klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), Kreu II. pika 16/b.d, me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qendrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” (Trajtuar më hollësisht në faqet 93-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Divjakë të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” sipas klasifikimit që i përket këtij posti, duke debituar llog 210 "Toka Troje Terrene" për vlerën 2,960,868 lekë që i përkasin aktiveve: “Lilishte tregu javor” në vlerën 1,865,026 lekë “Rikonstruksion lulishte” në vlerën 299,400 lekë, “Pemë dekorative” në vlerën 667,656 lekë dhe “Rikonstruksion lulishte nr. 2 fshati Grabian” në vlerën 398,246 lekë; debituar llog. 212 “Ndërtesa” për vlerën 33,631,525 lekë për aktivin “Ndërtim palestere, terrene sportive shkolla Muhedin Zaka”; debituar llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” për vlerën 4,162,380 lekë që i përket aktivitetit “Blerje materiale elektrike” në total në kredi të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vlerën 41,024,233 lekë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 109 artikuj aktive materiale në vlerën 10,200,802 lekë si orendi e paisje të ndryshme, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 “ Inventar ekonomik”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 pika 2. klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), Kreu II. pika 16/b.d, me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qendrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” (Trajtuar më hollësisht në faqet 95-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Divjakë të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” sipas klasifikimit që i përket këtij posti, duke debituar llog 218 “ Inventar

ekonomik” në kredi të llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” për vlerën në vlerën 10,200,802 lekë.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2017 në vlerën 3,570,731,613 lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 3,852,219,924 lekë është paraqitur e plotë pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje me 31.12.2018 në llogaritë: 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 3,787,474 lekë; 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 986,444,319 lekë; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 2,663,120,929 lekë; nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktiv, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventare janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 98-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandim: Drejtoria Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Divjakë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llog. 231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 dhe 2017 paraqitet në vlerën 0, kur në fakt ka investime në proces. Për kontratat e investimeve me shtrirje kohore më të gjatë se 1 vit rezulton se llogaritë 230-231 “*Shpenzime për investime në proces*” janë mbyllur në mënyrë të gabuar në debi të llogarive të klasës 20-21 sipas llojit të aktivitetit për vlera pjesore të paguara pa u kapitalizuar aktivet deri në vlerë të plotë. Kështu në fund të vitit 2018 për 22 kontrata të lidhura në vitet 2017-2018 e 3 kontrata para këtyre viteve janë paguar pjesërisht dhe gjendja e pa likuiduar deri me 31.12.2018 është në vlerën 119,611,503 lekë, vlerë e cila në fakt duhet ti përkiste gjendjes debitore prej 113,911,503 lekë të llog. 231 “*Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale (investime në proces)*” dhe gjendjes debitore prej 5,700,000 lekë të llog. 230 “*Shpenzime për Aktive Afatgjata jo-materiale (investime në proces)*”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 104-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandim: Drejtoria Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Divjakë të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale pasi, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*” deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave të kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga testimi e pagesave me banke dhe dokumentacionit të urdhër-shpenzimeve për 6-mujorin e parë 2018 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2019 rezulton se në gjendjen e llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” nuk janë kontabilizuar gjatë vitit dhe evidentuar në mbyllje të vitit 2017 vlera prej 114,999,248 lekë, e ndarë në vlerën prej 7,344,444 lekë e 11 faturave për shpenzime operative dhe në vlerën prej 107.654.804 lekë e 27 faturave të furnitorëve për investime dhe në mbyllje të vitit 2018 vlera prej 49,064,721 lekë, e ndarë në vlerën prej 10,270,575 lekë të 20 faturave për shpenzime operative në vlerën 38,794,146 lekë të 10 faturave të furnitorëve për investime. Këto vlera nuk janë kontabilizuar dhe përfshirë as në gjendjen e llogarisë 404 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to (për investime)*” të paraqitura në bilanc, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion jo real kontabël në mbyllje të PF të vitit 2017 dhe 2018 për detyrimet e Bashkisë Divjakë ndaj të tretëve. Këto veprime janë në kundërshtim me

Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 112-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandim: Drejtoria Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Divjakë të kryejë veprimet e kontabilizimit në rastet e kryerjes së veprimeve ekonomike për blerje mallrash e sherbimesh si dhe me investimet në momentin e mbërritjes së faturës dhe celjes së fondeve, për njohjen e detyrimeve ndaj frnitorëve duke prekur llogaritë përkatëse në mënyrë që në fund të vitit të ushtrimor të paraqiten në bilanc detyrimet reale ndaj të tretëve në llogaritë e detyrimeve.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se për vitet 2017-2018-2019 janë lidhur dhe zbatuar 56 kontrata në vlerën 2,082,144,454 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale si mallra apo projekte investimesh si, 41 kontrata në vlerën 517,681,066 lekë, 5 kontrata në vlerën 402,705,028 lekë të financuara nga Ministritë, 6 kontrata në vlerën 985,412,057 lekë të financuara nga FZHR dhe 4 kontrata në vlerën 176,346,303 lekë të financuara në mënyrë të përbashkët nga FZHR dhe Buxheti i Bashkisë. Nga testet e kryera për kontabilizimin e tre kontratave deri në vlerë të plotë, rezulton se për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e celjes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes por thjesht kur ndërhyjnë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" Kapitulli I, pika 1, me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 117-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1.Rekomandim: Drejtoria Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Divjakë të kryejë të gjitha veprimet e kontabilizimit sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike për kontratat e lidhura për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar, që nga çelja e fondeve, me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës), deri në kapitalizimin e aktivitetit dhe jo thjesht kur ndërhyjnë pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës Divjakë - Germenj", Bashkia Divjakë, me vlerë të kontratës 150,353,818 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik (BOE) "T..." SHPK & "A..." SHPK, rezultuan punime ndërtimi të kryera me cilësi të dobët dhe për pasojë ka patur dëmtime të rreth 250 m² sipërfaqe të shtresës asfaltike binder 5 cm dhe asfaltobeton 3 cm (*Trajtuar më hollësisht në faqet 165-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandim: Bashkia Divjakë, të marrë masa dhe t'i kërkojë kontraktorit BOE "T..." SHPK & "A..." SHPK që në zbatim të kushteve të kontratës me nr. 2225 prot, datë 11.07.2017 si dhe të procesverbalit për riparimin e defekteve dhe konkretisht të sipërfaqes së dëmtuar për shkak të cilësisë së dobët të punimeve me shpenzimet e veta, duke zbatuar me përpikmëri standardet teknike për riparimin e shtresave asfaltike binder dhe asfaltobeton si: prerje në forma të rregullta gjeometrike, ngjeshje të nënshtresave, hedhjen e binderit dhe të asfaltit në temperaturën e duhur dhe ngjeshjen e tij sipas specifikimeve teknike, për të siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Divjakë, Mbikëqyrësi i punimeve si

dhe Kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Divjakë, dhe 4 Njësitë Administrative, për mos pagimin në afat të detyrimit tatimore, më datën 31.12.2019 paraqitet vlera e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore në shumën **prej 307,653,839** lekë, e cila përfaqëson:

-284 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh, në vlerën 27,637,626 lekë,

-9,146 familjarë për taksat e tokës në vlerën 264,844,245 lekë,

-debitorë familjarë të tarifave vendore në vlerën 15,171,968 lekë, nga të cilat rreth 2911 familjarë në vlerën 9,213,500 lekë, nuk kanë paguar taksat në Ujësjellës sha Divjakë dhe 5,958,468 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 69-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Divjakë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **307,653,839 lekë**. Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimit tatimore për debitorët dhe të ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës Remas”, Bashkia Divjakë, me vlerë të kontratës (me tvsh) 10,992,660 lekë, fituar nga OE “N...” SHPK, rezultuan punime të kryera me cilësi të dobët dhe për pasojë ka patur dëmtime të rreth 150 m² sipërfaqe të shtresës asfaltike binder *(Trajtuar më hollësisht në faqet 180-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë, nisur nga fakti që ky objekt është brenda periudhës së garancisë së difekteve, të merren masa për detyrimin e kontraktorit për riparimin e sipërfaqes së dëmtuar për shkak të cilësisë së dobët të punimeve, me shpenzimet e veta, duke zbatuar me përpikmëri standardet teknike për riparimin e shtresave asfaltike si: prerje në forma të rregullta gjeometrike, ngjeshje të nënshtresave, hedhjen e binderit në temperaturën e duhur dhe ngjeshjen e tij sipas specifikimeve teknike. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Divjakë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Divjakë)**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 2,511,092 lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës Remas”, Bashkia Divjakë**, me vlerë të kontratës (me tvsh) 10,992,660 lekë, fituar nga OE “N...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 479,930 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 224/23 prot, datë 24.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Divjakë dhe OE “Nika” SHPK (*Trajtuar më hollësisht në faqet 180-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **479,930 lekë pa tvsh** nga OE “N...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 224/23 prot datë 24.05.2019, me objekt **“Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës Remas”, Bashkia Divjakë**, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksion i Shkollës 9-vjecare “Koli Sako”, Bashkia Divjakë**, me vlerë të kontratës (me tvsh) 47,870,959 lekë, fituar nga BOE “A...” SHPK & “C...” shpk & “M...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 364,646 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3226 prot datë 11.07.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Divjakë dhe BOE (*Trajtuar më hollësisht në faqet 181-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **364,646 lekë pa tvsh** nga BOE “A...” SHPK & “C...” shpk & “M...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3226 prot datë 11.07.2017, me objekt **“Rikonstruksion i Shkollës 9-vjecare “Koli Sako”, Bashkia Divjakë**, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës “Unaza e sipërme e fshatit Kryekuq”, Bashkia Divjakë**, me vlerë të kontratës (me tvsh) 37,963,200 lekë, fituar nga BOE “Xh...” SHPK & “G...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 255,600 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1633 prot datë 05.04.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Divjakë dhe BOE (*Trajtuar më hollësisht në faqet 184-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **255,600 lekë pa tvsh** nga BOE “Xh...” SHPK & “G...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1633 prot datë 05.04.2019, me objekt **“Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës “Unaza e sipërme e fshatit Kryekuq”, Bashkia Divjakë**, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës Çermë Sektor, Njësia Administrative Terbuf” Bashkia Divjakë**, me vlerë 13,802,736 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “B...” SHPK & “P...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në vlerën **516,880 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 2180/10 Prot, datë 09.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Divjakë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) (*Trajtuar më hollësisht në faqet 169-173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **516,880 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “B...” SHPK & “P...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2180 prot, datë 09.08.2019 me objekt **“Rikonstruksion i dhe zgjerim i rrugës Çermë Sektor, Njësia Administrative Terbuf”, Bashkia Divjakë**, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion + shtesë anësore shkolla 9-vjeçare “Hysni Malko”, fshati Kryekuq” Bashkia Divjakë, me vlerë 29,731,440 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “S...” SHPK & “E...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në vlerën **480,850 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 2180/10 Prot, datë 09.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Divjakë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) (*Trajtuar më hollësisht në faqet 173-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia Divjakë, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)) “S...” SHPK & “E...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **480,850 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë me datë 02.12.2020 për të garantuar silësinë dhe funksionalitetin e shkollës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Divjakë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit brenda periudhës së garancisë (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, fshati Karavasta e Re” Bashkia Divjakë, me vlerë 19,101,654 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “Xh...” SHPK & “K...” SHPK & “G...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në vlerën **258,386 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2453 Prot, datë 24.05.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Divjakë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) (*Trajtuar më hollësisht në faqet 175-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia Divjakë, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE)) “Xh...” & “G...” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **258,386 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës 31 mars 2020, për të garantuar silësinë, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e shkollës. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Divjakë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i banesave të komunitetit Rom dhe Egjiptian, Njësia Administrative Grabjan” Bashkia Divjakë, me vlerë 31,745,629 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) “J...” SHPK & “N...” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në vlerën **152,700 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3149 Prot, datë 28.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Divjakë dhe (BOE) (*Trajtuar më hollësisht në faqet 178-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia Divjakë, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)) “J...” SHPK & “N...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **152,700 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së punimeve me datë 06.12.2020. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Divjakë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

C.1. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën objekt auditimi, janë konstatuar 5 procedura me të meta, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **2,122,921 lekë** jo duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve por duke skualifikuar OE për shkaqe të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat kanë sjellë pasoja me efekte negative. Konkretisht:

C.1.1 Gjetje nga auditimi: “Blerje kancelarie per Bashkine Divjake”, viti 2018, “Kërkesë për propozim”, F.L. 3,381,995 lekë, shpallur fitues OE “E...” shpk, me ofertën 1,930,364 lekë, diferenca me ofertën e OE të skualifikuar “Infosoft” shpk, në shumën 1,534,901 lekë, është **395,463 lekë**.

Përsa trajtuar është objekt i vendimmarrjes së KVO si dhe kërkesë e tepruar dhe subjektive e vendosur nga Njësia e Prokurimit në kërkesat teknike në DST. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar përdorim jo sipas të 3-E të fondeve prej **395,463 lekë**.

C.1.2. Gjetje nga auditimi: “Blerje materiale ndërtimi për KUZ për Nj/Adm Tërbuf , Bashkinë Divjakë” viti 2018, “Kërkesë për propozim”, F.L. 7,523,320 lekë, shpallur fitues OE “V...” shpk, me ofertën 5,705,000 lekë, diferenca me ofertën e OE të skualifikuar “M...” shpk, në shumën 5,297,200 lekë, është **407,800 lekë**.

Përsa trajtuar është objekt i vendimmarrjes së KVO. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar përdorim jo sipas të 3-E të fondeve prej **407,800 lekë**.

C.1.3. Gjetje nga auditimi: “Blerje zjarrfikëse për shërbimin e MZSH-se, Bashkia Divjakë” viti 2018, “Kërkesë për propozim”, F.L. 4,166,666 lekë, shpallur fitues OE “L...” shpk, me ofertën 4,100,000 lekë, diferenca me ofertën e OE të skualifikuar “A...” shpk, në shumën 3,644,444 lekë, është **455,556 lekë**.

Përsa trajtuar është objekt i vendimmarrjes së KVO. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar përdorim jo sipas të 3-E të fondeve prej **455,556 lekë**.

C.1.4. Gjetje nga auditimi: “Blerje lubrifikantesh (vajra, filtra, graso) Për mjetet e Bashkise Divjake” viti 2019, “Kërkesë për propozim”, F.L. 2,253,667 lekë, shpallur fitues OE “T...” shpk, me ofertën 1,810,760 lekë, diferenca me ofertën e OE të skualifikuar “K...” shpk, në shumën 1,489,030 lekë, është **321,730 lekë**.

Përsa trajtuar është objekt i vendimmarrjes së KVO. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar përdorim jo sipas të 3-E të fondeve prej **321,730 lekë**.

C.1.5. Gjetje nga auditimi: “Blerje kancelarie për Bashkinë Divjake”, viti 2019, “Kërkesë për propozim”, F.L. 2,491,465 lekë, shpallur fitues OE “A...”, me ofertën 2,087,000 lekë.

Përsa trajtuar është objekt i vendimmarrjes së KVO. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar përdorim jo sipas të 3-E të fondeve prej **542,372 lekë**.

C.1.(1-5)1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Divjakë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, për gjetjet e më sipërme, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën totale **2,122,921 lekë pa tvsh** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Në vijimësi

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA DHE TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTUR (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Divjakë ka lidhur kontrata qeraje me subjekte të ndryshëm për dhënie të aseteve në pronësi të saj, ku rezultojnë se P.M. është debitor për 1,475,787 lekë, H.M. është debitor për 811,678 lekë, L.V. është debitor për 631,227 lekë, L.V. është debitor për 929,112 lekë, R.H. është debitor për 149,323 lekë, "A...C" SHPK është debitor për 511,395 lekë, S.P. është debitor për 1,615,165 lekë, "L...J SHPK është debitor për 243,800 lekë në mospërputhje me ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënjes me qera dhe enfiteoz" i ndryshuar me VKM nr. 291, datë 02.05.2012.

Nga 19 kontrata qiraje të marra nga subjekte me aktivitet të ndryshëm 8 prej këtyre subjekteve janë debitorë në vlerën **6,367,488 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Divjakë (*Trajtuar më hollësisht në faqen 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **6,367,488 lekë** nga subjektet me të cilët ka lidhur kontrata qeraje si P.M. debitor në vlerën 1,475,787 lekë, H.M. debitor në vlerën 811,678 lekë, L.V. debitor në vlerën 631,227 lekë, L.V. debitor në vlerën 929,112 lekë, R.H. debitor në vlerën 149,323 lekë, "A...C" Shpk debitor në vlerën 511,395 lekë, S.P. debitor në vlerën 1,615,165 lekë, "L..." SHPK debitor në vlerën 243,800 lekë, duke u mbështetur në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënjes me qera dhe enfiteoz" i ndryshuar me VKM nr. 291, datë 02.05.2012.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Bashkia Divjakë, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezultojnë se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë me vlerë **5,958,468 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Divjakë. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Bashkia Divjakë, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **5,958,468 lekë**.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE:

Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe me kontratë pune.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germat (b, c, ç) e nenin 58-“*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9- “*Masa disiplinore*”, të kontratës individuale, dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Divjakë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor**, pranë Institucionit të Bashkisë, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Menjëherë

F. SHENIM I KRYETARIT

Në vijim të këtij auditimi, përgjatë muajit qershor-korrik 2020, përgjegjësi i grupit me dy auditues do të rikthehet në Bashkinë Divjakë me objekt plotësimin e programit të auditimit për çertifikimin e pasqyrave financiare dhe/ose dhënien e opinionit të auditimit për vitin 2019, me qëllim që të reflektohen në raportin e Zbatimit të Buxhetit Faktik për vitin 2019 që Kontrolli i Lartë i Shtetit do të paraqesë në Kuvend në tetor të vitit 2020, saktësimin e kryerjes së veprimeve në rekomandimin sipas pikave B.21 dhe B.23 si dhe plotësimin e rekomandimit të KLSH të pasqyruar në pikën B.7.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R